Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6

Dokumentat Standarde të Tenderit

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e _____ të personit juridik _____ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË
Mbi konfliktin e interesave

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit**

e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME*

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- **Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:**

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 8/1

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në

Dokumentat Standarde të Tenderit

datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin

e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës*, sipas **Shtojcës 1** (ku të formulari të plotësohet me të dhënat për sasinë e pritshme, çmimin për njësi dhe vlerën e pritshme të kontratës).

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas **Shtojcës 2/1**;

c. Lista e informacionit konfidencial sipas **Shtojcës 5**

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas **Shtojcës 6**;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas **Shtojcës 7**;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas **Shtojcës 8/1**;

e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Dokumentat Standarde të Tenderit

(Shënim: Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveçrastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë).

Shënim*: OE/BOE ofertues, në rastin që oferton me më shumë se një prodhues, duhet të saktësojë (përcaktojë) sasinë që do të sjellë për të përmbushur kontratën për secilin prodhues.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Kopje të çertifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (**2017, 2018**) të operatorit ekonomik pjesmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet.
- b) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2016, 2017 dhe 2018**) ku vlera mesatare e tyre të jete **sa 40% i vleres se fondit limit*** të objektit të prokurimit.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.12 / Seksioni 2 i DST.

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **sa 30% e vleres se fondit limit*** të objektit të prokurimit të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohet kontrata/kontratat përkatëse të shoqeruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj/te tyre.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen qarte datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 30% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.12 / Seksioni 2 i DST.

- c) Për të gjithë artikujt e ofertuar me shenjën asterisko* (përkatesisht artikujt 1,3,5,9,12,14,15,19) tek numri, duhet të paraqiten mostra ditën e hapjes së ofertave, me date **12.06.2020 në orën 10:00**.

Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet pranë Drejtorisë Juridike / Sektori Prokurimeve, QSUT “Nene Tereza”, të mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet:

- “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « » dhe jo para datës ____ . ____ .2020, ora ____ : ____.
- Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkrësë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- *Mbi çdo mostër te dorëzuar; ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.*

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçantë, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s'kualifikohet.

c) Kërkohet deklarate e ofertuesit mbi origjinen e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese) per secilin artikull; per plotësimin e afatit te skadences se tyre, si dhe respektimit te specifikimeve teknike te lotit/lotëve qe oferton. *Data e skadencës për materialet mjekesore objekt prokurimi, në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.*

ç) Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (*pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen*). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (**te markuara sipas artikullit**) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

d) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim te leshuar nga Prodhuesi ose Distributori Zyrtar i autorizuar/MAH/*(ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin)* nëpërmjet te cilit konfirmohet se autorizohet të tregtoje materialet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet te jete i vlefshem ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave; dhe origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara.

e) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi "*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*", me objekt aktiviteti te certifikates per tregetim të materialeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

ë) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesi Certifikaten **ISO 9001:2015** mbi "*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*" ose **EN ISO 13485:2016** mbi "*Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore*" ose **SSH EN ISO 13485:2016** mbi "*Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore*", të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

f) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autodeklarate për materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) per konformitetin me normat **MDD 93/42/EEC** ose **98/79 EC**, ose **2015/1535/EU**, kur eshte e aplikueshme, sipas **Direktivave dhe klasifikimit te Keshillit te Europes**, bashkëlidhur me kopjet te certifikatave perkatese **CE/DC (Deklarate konformiteti)**, origjinale, ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara, te vlefshme ne momentin e dorezimit.

g) Operatori ekonomik duhet te paraqese oferten teknike, per artikujt e kerkuar ne forme table,

Dokumentat Standarde të Tenderit

ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Nr.	Materiali mjekësor	Specifikime	Njësia	Sasia
1 *	FitilVeshi	Me përbërjepolivinilacetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim të lartë, hemostatik dhe biokompatibel, me përmasa: gjatësi 9.0 mm, gjerësi 24 mm	Copë	400
2	Otofitil	Me përbërjepolivinilacetat i hidroksilizuar, me vrimë qendrore për të mbajtur hapur kanalën e veshit, sterile, me përmasa: 24mm	Copë	600
3*	Protezë Osikulare parcial e	Me sipërfaqet e rrumbullakët formë sheehy, diametri i kokës 3mm, diametri brendshëm 1.17mm, gjatësi 4.75mm	Copë	40

Dokumentat Standarde të Tenderit

4	Tub ventilimi I përkohshëm	Material FLPL, ID 1.14	Copë	250
5*	Tub ventilimi I përkohshëm në formë T	Material silikoni, ID 1.14	Copë	150
6	Inserues I tubavetëventilimit	Për tuba-T me gjatësi 12mm derinë 6mm	Copë	2
7	Spongel standard	Haemostasis 2 - 4 minutes; dimensionet 80 x 50 x 10 mm; i absorbueshëm brënda 4 javësh; 100% Biodegradim	Copë	350
8	Spongel Size 12-7	Dimensionet 60 x 20 x 7 mm; i absorbueshëm brënda 4 javësh; 100% Biodegradim	Copë	200
9*	Spongel special	Dimensionet 80 x 50 x 1 mm; i absorbueshëm brënda 4 javësh; 100% Biodegradim	Copë	450
10	Spongel Tampon	Diameter 30 x 80 mm; i absorbueshëm brënda 4 javësh; 100% Biodegradim	Copë	200
11	Spongel paste pudër	Tubet 1 gr; i absorbueshëm brënda 4 javësh; 100% Biodegradim	Copë	40
12*	Spongelkub	Dimensionet 10 x 10 x 10 mm; i absorbueshëm brënda 4 javësh; 100% Biodegradim	Copë	200
13	Hemostat me densitet të lartë	I absorbueshëm, me përbërje polyoxyanhydroglucuronic acid, dimensionet 76x102mm +/-2mm	Copë	36
14*	Elektrodetonillektomie	Elektrodebipolare e avancuar përmbylljendhëtarjen e enëve të gjakut dhe nyjeve limfatike derinë 3mm, gjatësi boshti 12cm, me nofulla 12mm të harkuara, të ndalojnë energjinë automatikisht pas të ketë të përfunduar mbyllja	Copë	5
15*	Tub ventilimi I përkohshëm në formë butoni	Material FLPL, ID 1.14	Copë	100
16	Kateternazal	Kateternazal me unazë bajteselehtësisht të rregullueshme për epistaksis me balon posterior dhe funksion për masazh 5.5 cm x 1.5 cm x 2.5 cm (GjxTxL) me udhëzues ajri integral të heqshëm	Copë	30
17	Splint ekstranazal	Me tre përmasa 1.25cm 1.53cm dhe 1.73 cm prej material termoplastik, I përpunueshëm dhe I zbutshëm në ujë, I fortë pas pozicionimit	pale	140
18	Ligature për mbyllje plaje e paabsorbueshme USP 5-0	Me përberje polibutester me elasticitet të kontrolluar monofilament hidrofob gjatësi 30-45 cm me age 3/8 rrethore, 19 mm premium reverse cutting	Copë	72

Dokumentat Standarde të Tenderit

19*	Sfungjer intra-operativ	Perberjepolivinilacetat I hidrokilizuar I perputhshem me tubinendotrakeal per ndalimin e hyrjes se gjakut ne rruget e frymemarrjesosetraktin gastro intenstinal	Copë	100
20	Hemostat standart knit	I absorbueshem ne perberjepolyoxyanhidroglucuronik acid me dimensione 12.5 x 50 mm	Copë	70
21	Disk otologjik	Disk otologjik I paprere 8 mm ne formeteesterifikuarprejacidihialuronik per procedurat e timpanoplastikes	Copë	18

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE PERGJITHESHME:

- Afati i Skadences: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.
- Kerkohet autodeklarate për materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) per konformitetin me normat MDD 93/42/EEC ose 98/79/EC, dhe ISO 9001 ose EN ISO 13485, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese CE/DC (Deklarate konformiteti) kur eshte e aplikueshme sipas Direktivave dhe klasifikimit te Keshillit te Europes, origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara te vlefshme ne momentin e dorezimit.
- Materialet mjekesore duhet te jene te markuara CE.
- Regjistrim nga AKBPM (Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore).
- Materiali I implantueshem duhet te jete conform directives 90/385/EEC
- Autorizim nga MAH / prodhuesi ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi.
- Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogë, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut qe përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nëse nuk janë ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). **Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun përkatës produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te përcaktuar ne formularin e ofertës.** Katalogët do pranohen vetëm ne forme elektronike nëpërmjet sistemit elektronik te prokurimit
- Operatori ekonomik duhet te paraqesë ofertën teknike, për artikujt e kërkuar ne forme tabele, ku te plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emërtimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet përkatëse për produktet.
- Për artikujt e mësipërm me shenjën asterisko (*) tek numri, duhet te paraqiten mostra ditën e hapjes se ofertave
- Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimi për çdo artikull.

Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

	Mall:	Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes
Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Kontratat do të jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me OE te shpallur fitues, me afat perfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK.

Afatet e lëvrimit: QSUNT do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 muaj. Përjashtimisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Për çdo kontratë të lidhur brenda marrëveshjes kuadër, sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimit do të jene si me poshtë:

- **15% e sasisë për secilin material mjekësor do të lëvrohet brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës. Përjashtimisht, AK përcakton artikujt, sasia e të cilëve**

Dokumentat Standarde të Tenderit

do të lëvrohet e plotë brenda afatit prej 20 ditësh.

- *pjesa e sasisë se mbetur duhet të lëvrohet deri ne përfundim te kontratës dhe sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor.*

Nr.	Materiali mjekësor	Specifikime	Njësia	Sasia
1 *	FitilVeshi	Me përbërjepolivinilacetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfishtë, me absorbim të lartë, hemostatik dhe biokompatibel, me përmasa: gjatësi 9.0 mm, gjerësi 24 mm	Copë	400
2	Otofitil	Me përbërjepolivinilacetat i hidroksilizuar, me vrimë qëndrore për të mbajtur hapur kanalën e veshit, sterile, me përmasa: 24mm	Copë	600
3*	Protezë Osikulare parcial e	Me sipërfaqet e rrumbullakët formë sheehy, diametri i kokës 3mm, diametri brëndshëm 1.17mm, gjatësi 4.75mm	Copë	40
4	Tub ventilimi I për kohshëm	Material FLPL, ID 1.14	Copë	250
5*	Tub ventilimi I për kohshëm në formë T	Material silikoni, ID 1.14	Copë	150
6	Inserues I tubave të ventilimit	Për tuba-T me gjatësi 12mm derinë 6mm	Copë	2
7	Spongel standard	Haemostasis 2 - 4 minutes; dimensionet 80 x 50 x 10 mm; i absorbueshëm brenda 4 javësh; 100% Biodegradim	Copë	350
8	Spongel Size 12-7	Dimensionet 60 x 20 x 7 mm; i absorbueshëm brenda 4 javësh; 100% Biodegradim	Copë	200
9*	Spongel special	Dimensionet 80 x 50 x 1 mm; i absorbueshëm brenda 4 javësh; 100% Biodegradim	Copë	450
10	Spongel Tampon	Diameter 30 x 80 mm; i absorbueshëm brenda 4 javësh; 100% Biodegradim	Copë	200
11	Spongel paste pudër	Tubet 1 gr; i absorbueshëm brenda 4 javësh; 100% Biodegradim	Copë	40
12*	Spongel kub	Dimensionet 10 x 10 x 10 mm; i absorbueshëm brenda 4 javësh; 100% Biodegradim	Copë	200
13	Hemostat me densitet të lartë	I absorbueshëm, me përbërjepolyoxyanhydroglucuronic acid, dimensionet 76x102mm +/-2mm	Copë	36
14*	Elektrode të sillektomie	Elektrode bipolare e avancuar për mylljendhëtarjen e enëve të gjakut dhe nyjeve limfatike derinë 3mm, gjatësi boshti 12cm, me nofulla 12mm të harkuara, të ndalojnë energjinë automatikisht pas të ketë përfunduar mylljendhjen	Copë	5

Dokumentat Standarde të Tenderit

15*	Tub ventilimi I perkohshem ne formebutoni	Material FLPL, ID 1.14	Copë	100
16	Kateternazal	Kateternazal me unazembajteselehtesishtterregullueshme per epistaksis me balon posterior dhesfungjerpermasa 5.5 cmx1.5cmx2.5cm (GjxTxL)me udhezuesajri integral teheqshem	Copë	30
17	Splint ekstranazal	Me trepermasa 1.25cm 1.53cm dhe 1.73 cm prejmaterialitermoplastik, I perpunueshemdhe I zbutshem ne uje, I forte pas pozicionimit	pale	140
18	Ligature per mbylljeplage e paabsorbueshme USP 5-0	Me perberjepolibutester me elasticitetekontrolluarmonofilamnehidrofo bikegjatesi 30-45 cm me age 3/8 rrethore, 19 mm premium reverse cuttinge	Copë	72
19*	Sfungjer intra-operativ	Perberjepolivinilacetat I hidrokilizuar I perputshem me tubinendotrakeal per ndalimin e hyrjes se gjakut ne rruget e frymemarrjesosetraktin gastro intenstinal	Copë	100
20	Hemostat standart knit	I absorbueshem ne perberjepolyoxyanhydroglucuronik acid me dimensione 12.5 x 50 mm	Copë	70
21	Disk otologjik	Disk otologjik I paprere 8 mm ne formeteesterifikuarprejacidihialuronik per procedurat e timpanoplastikes	Copë	18

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Dokumentat Standarde të Tenderit

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: *[Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]*

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: d oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
---------------------------------	------------------------

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
---------------------------------	------------------------

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ /Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME **Mallrat – Tender i Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi,

kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
